



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:108588
Datë: 23.12.2020
Numri i dokumentit: 01367691
C.nr.1060/20

GJYKATA THEMELORE PEJË-Departamenti i përgjithshëm, gjyqtarja Afërdita Mulhaxha, në çështjen juridiko civile-kontestimore të paditësit A. B., nga, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Hasan Haxhaj, avokat në Glllogoc, kundër të paditurës K. e.....-D. e A., për shkak të kompensimit të pagave jubilarë, vlera e kontestit: 590€, jashtë seance, me dt.23.12.2020, merr këtë:

A K T G J Y K I M
NË BAZË TË HEQJES DORË NGA KËRKESËPADIA

I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit A. B., nga, më të cilën ka kërkuar që të „DETYROHET e paditura K. e-D. e A., që paditësit si mësimdhënëse në Shkollën Filllore të Mesme të Ultë “....” në fshatin, Komuna e Pejës, t’ia paguaj kompensimin për pagat jubilarë, sipas nenit 35 par. 8 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Arsimit të Kosovës, shumën prej 590€, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi”.

II. DETYROHET e paditura K. e-D. e A., që paditësit A. B., nga, që në emër të shpenzimeve të procedurës t’i paguajë shumën prej 124€, në afat prej 15 ditësh nga marrja se këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësi nëpërmes përfaqësuesit sipas autorizimit, me dt.04.09.2020, ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Pejë, kundër të paditurës, për shkak të kompensimit të pagave jubilarë.

I autorizuari i palës paditëse, në seancën gjyqësore të dt.08.12.2020, ka hequr dorë nga kërkesa kryesore e padisë, me arsyetim se e paditura D. e A. ne K. e, e ka përmbushur detyrimin e saj ndaj paditësit, ndërsa i njëjti i ka kërkuar shpenzimet e procedurës, dhe ate për taksë gjyqësore për padi në shumën prej 20€, për përpilim të padisë shumën prej 104€, dhe shpenzimet për një përfaqësim në shumën prej 135€.

Pasi që i autorizuari i palës paditëse ka hequr dorë nga kërkesa kryesore, gjykata pa shqyrtim të mëtejme ka marr aktgjykim si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimit, me të cilin ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit, konform dispozitës së nenit 149.1 të LPK-së.

Gjykata duke e vlerësuar kërkesën për shpenzime të procedurës, gjeti se paditësit i takojnë shpenzimet e procedurës sa i përket taksës për padi në shumën prej 20€, dhe për përpilimin e padisë shumën prej 104€, e në shumën e tërësishëm prej 124€, në mbështetje të dispozitës nga neni 449 dhe 452 të LPK-së, ndërsa kërkesën për përfaqësim në seancën gjyqësore të dt.08.12.2020, gjykata e ka refuzuar si të pabazuar, për shkak se i autorizuari i palës paditëse me kohë ka qenë i njoftuar se e paditura e ka përmbushur detyrimin e saj ndaj

paditësit, me çka nuk ka pas arsyeje të krijoj shpenzime të panevojshme duke e përfaqësuar paditësin ne seancën e dt.08.12.2020.

Andaj nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË, C.nr.1060/20, me dt.23.12.2020.

Gj y q t a r j a
Afërdita Mulhaxha

KËSHILLA JURIDIKE:

*Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditësh,
nga dita e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.*